

# E DREJTA E INFORMIMIT

# 2018

Janar 2019



Informacioni  
i vonuar  
është  
informacion  
i mohuar

 CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS

  
SWEDEN

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Civil Rights Defenders me fonde të qeverisë suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe nuk reflekton opinionin e Civil Rights Defenders.

Autorë:

Av. Dorian Matlija

Dr. Irena Dule

Ndihmoi grupi i punës i përbërë nga:

Av. Arbësa Kurti

Av. Brunilda Qershori

Botues: Qendra “Res Publica”

Tirazhi: 200 kopje

Layout & Print: Expo Vision Albania

# E DREJTA E INFORMIMIT 2018

---

Informacioni  
i vonuar  
është  
informacion  
i mohuar

# PERMBAJTJA

## 5 Hyrje

---

## 7 Metodologjia

---

## 8 Transparenca proaktive e institucioneve

---

8 Programet e transparencës

---

11 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

---

12 Çaktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit

---

## 13 Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave për informacion

---

13 Fusha e informacionit të kërkuar

---

14 Kategoritë e institucioneve të pyetur

---

14 Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare

---

15 Kohëzgjatja e përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

---

16 Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ

---

17 Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ

---

## 19 Vlerësimi i punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

---

20 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

---

21 Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

---

21 Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

---

22 Lloji i vendimeve të marra nga Komisioneri

---

22 Kohëzgjatje e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

---

23 Aplikimi i sanksioneve

---

24 Seancat dëgjimore

---

## 25 Çështje me interes të veçantë lidhur me të drejtën e informimit

---

25 Publikimi i informacioneve për vendimmarrjet me impakt në mjedis

---

27 Mospublikimi i vendimeve gjyqësore

---

28 Aksesit në marrëveshjet e koncensioneve nuk pengohet nga konfidencialiteti

---

28 Publikimi i informacioneve me natyrë statistikore, pavarësisht se statistikatat u referohen çështjeve që kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tjera

---

29 Publikimi i informacionit për detyrimet tatimore të tatimpaguesve, për të cilat kanë nisur procedurat e mbledhjes me forcë

---

30 Të dhënat financiare të shoqërive tregtare shtetërore

---

## 33 Të dhëna nga platforma "Publeaks.al"

---

34 Përdorimi i faqes Publeaks.al

---

34 Aplikantët sipas kategorive

---

35 Aplikantët sipas grupmoshave

---

35 Aplikantët sipas arsimimit

---

36 Aplikantët/et sipas gjinisë

---

37 Publeaks.al si një aplikacion i ri për smartphone

---

## 39 Konkluzione

## 45 Rekomandime



# I HYRJE

Ky raport u përgatit nga Qendra Res Publica, me mbështetjen e Civil Right Defenders në kuadër të projektit “Promovimi i aksesit të qytetarëve në të drejtën e informimit. Vlerësimi i punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit”.

Viti 2018 është viti i katërt që Qendra Res Publica monitoron zbatimin e ligjit nr.146/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke pasur në fokus nga njëra anë interesin e qytetarëve për të përdorur të drejtën për t’u informuar dhe nga ana tjetër sjelljen e institucioneve publike, për garantimin dhe respektimin e të drejtës së qytetarëve për t’u informuar.

Nga momenti i miratimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” (2014), janë bërë monitorime të vazhdueshme, testime të praktikës administrative apo gjyqësore për të vendosur dhe rishikuar kufijtë e zbatimit të ligjit, si dhe praktikës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, duke krijuar një bazë të mirë të dhënash për të sjellë një vlerësim krahasues mbi efektivitetin e të drejtës së informimit në Shqipëri gjatë periudhës që nga viti 2014 e deri më sot.

Në këtë raport prezantohen rezultatet e gjetura nga monitorimi për vitin 2018 krahasuar me vitet e mëparshme të performancës së institucioneve shtetërore, lidhur me plotësimin dhe përditësimin e programeve të transparencës, publikimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit për kërkesat dhe përgjigjet, sjelljen e institucioneve ndaj kërkesave për informacion, etj.

Raporti prezanton edhe disa rezultate që dalin nga përpunimi i të dhënave të marra nga platforma Publeaks.al gjatë dy viteve të fundit.

Platforma publeaks.al u krijua nga Qendra Res Publica dhe nisi funksionimin në dhjetor 2016, për t’i ardhur në ndihmë qytetarëve që dëshirojnë të informohen për çështje të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, duke ia lehtësuar punën. Një qytetar mjafton të shfaqë kuriozitet për një çështje të caktuar, pa pasur nevojë të ketë dijeni se kujt duhet t’i drejtohet pyetja apo si duhet formuluar kërkesa dhe stafi që menaxhon platformën përgatit pyetjen në formën e duhur, duke i kushtuar rëndësi formulimit sa më konkret të kërkesës për të mos pasur vend

për ekuivoke. Më pas stafi ndjek të gjitha hapat, duke përfshirë edhe ankimet administrative dhe gjyqësore, deri në marrjen e plotë të informacionit. Pasurimi i platformës e shndërron atë në një arkivë me një shumëllojshmëri informacionesh, të cilat janë siguruar më parë nga aplikimet në platformë dhe janë të aksesueshme nga publiku në çdo kohë.

Me qëllim lehtësimin e vazhdueshëm të aksesit të publikut te platforma Publeaks.al, tashmë ky shërbim mund të aksesohet edhe mes telefonit celular, pas krijimit të aplikacioneve për android dhe IOS (Iphone), të cilat ndodhen ende në fazë eksperimentale.

Res Publica, si një nga organizatat më aktive në fushën e monitorimit dhe testimit të ligjit për të drejtën e informimit, edhe gjatë këtij projekti është përpjekur ta verë në provë efektivitetin e ligjit, duke testuar në mënyrë aktive, me fokus të veçantë aty ku perceptohet se ka më shumë dobësi, të cilat përbëjnë shteg për zyrtarët që nuk dëshirojnë të japin informacionin e kërkuar. Një aspekt i veçantë është edhe testimi i respektimit të të drejtës për t'u informuar, kur kjo e drejtë është në kufi me respektimin e të drejtave të tjera, siç janë rastet e mbrojtjes së sekretit tregtar, të dhënave personale etj. Me fjalë të tjera, testimi i zbatimit të ligjit është zgjeruar përtej praktikës së zakonshme dhe rutinë.

Vlen të theksohet se gjithë puna e bërë në kuadër të projektit dhe që prezantohet në këtë raport, dhe jo vetëm studimi në vetvete, ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, lehtësimin e aksesit të këtij të fundit në informacionit publik, në përmbushjen më të mirë të funksioneve të zyrtarëve përgjegjës për dhënien e informacionit.

Në vlerësimin tonë studime të këtij lloji i shërbejnë më mirë publikut dhe mirëqeverisjes kur evidentohen dukuri problematike, të cilat në pamje të parë nuk pikasen, në vend të dhënies së një tabloje të ftohtë me vlerësime të dhënash që edhe pse lidhen me efektivitetin e ligjit, jo domosdoshmërisht e rrisin transparencën.

Ky raport shoqërohet me rekomandime konkrete, një pjesë e tyre të përsëritura, për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe praktikës në zbatim të tij, për ta bërë administratën publike sa më transparente dhe qytetarin më të ndërgjegjshëm dhe më të motivuar për përdorimin e tij.

Autorë: Av. Dorian Matlija  
Dr. Irena Dule

Ndihmoi grupi i punës i përbërë nga:

Av. Arbesa Kurti  
Av. Brunilda Qershori



## 2 METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është prezantimi i të dhënave nga monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit gjatë vitit 2018, i cili vjen si vazhdimësi e studimeve të mëparshme për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Gjetjet janë krahasuar me ato të tre viteve të shkuara, duke ruajtur të njëjtën metodologji për sa ka qenë e mundur, dhe duke vazhduar me monitorimin. Veçantia e monitorimit të dy viteve të fundit (2017, 2018) vjen përmes angazhimit të platformës Publeaks.al, e krijuar në fund të vitit 2016.

Analiza është fokusuar në disa drejtime:

*Së pari*, është monitoruar veprimtaria e institucioneve publike duke vlerësuar transparencën proaktive të tyre, në rastin e publikimit të informacioneve pa kërkesë. Në këtë kuptim jemi ndalur te plotësimi, përshtatja dhe përditësimi i programeve të transparencës. Më konkretisht janë përzgjedhur për monitorim 100 autoritete publike me rëndësi më madhe, duke marrë kampione me 20 institucione në 5 kategori kryesore: (1) institucione kushtetuese dhe të pavarura; (2) institucione qendrore të pushtetit ekzekutiv; (3) institucione të vartësisë të pushtetit ekzekutiv; (4) institucione të pushtetit vendor; (5) institucione të pushtetit gjyqësor. Monitorimi është fokusuar në përmbushjen e të gjithë elementëve që duhet të përmbajë një program transparencë, duke i dhënë rëndësi atyre elementëve që lidhen me informacione të vlefshme dhe përgjithësisht sensitive dhe duke i dhënë një rëndësi më të vogël informacioneve që nuk kanë peshë të rëndësishme në informimin e publikut.

*Së dyti*, është monitoruar ngritja e kapaciteteve të nevojshme që çdo institucion të bëjë të mundur funksionimin e detyrimeve me të cilat e ngarkon ligji. Në këtë kuptim është monitoruar caktimi i *koordinatorëve për të drejtën e informimit*, si dhe publikimi dhe mirëmbajtja e *regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve*.

*Së treti*, është testuar dhe vlerësuar reagimi i institucioneve, duke vlerësuar përmes kritereve të matshme, sjelljen e tyre ndaj kërkesave për informacion. Më konkretisht janë dërguar 254

kërkesa për informacion dhe është analizuar i gjithë rrugëtimi administrativ i tyre. Kërkesat kanë nisur kryesisht përmes aplikimit në faqen Publeaks.al. Nga 254 kërkesa janë përzgjedhur 202 prej tyre, për të bërë një krahasim të drejtë me periudhat e mëparshme dhe për të bërë të mundur ruajtjen e të njëjtës balancë në ndarjen e fushave si në vitet 2015, 2016 dhe 2017. Disa nga treguesit kryesorë të matshëm që janë marrë në konsideratë janë: (1) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes; (2) Nëse përgjigjia ka qenë e plotë apo e pjesshme; (3) Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ.

*Së katërti*, është monitoruar veprimtaria e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si autoriteti i krijuar posaçërisht nga ligji për të garantuar funksionimin e tij. Veprimtaria e Komisionerit është parë në një këndvështrim kritik sepse relaksimi i kësaj zyre në raport me shkeljet mund të sjellë pasoja afatgjata në formimin e zakoneve që minojnë qëllimin e ligjvënësit dhe cenojnë një të drejtë kushtetuese me rëndësi parësore në një shoqëri demokratike. Përmes informacioneve të siguruar nga zyra e Komisionerit, janë paraqitur të dhëna për numrin e ankesave, mënyrës së trajtimit të tyre, vendimet e marra, sanksionet e vendosura, etj.

*Së pesti*, Res Publica ka kryer edhe një sërë testimesh ku objekti i kërkimit të informacioneve është i diskutueshëm sepse ndodhet në kufijtë e lejuar nga ligji, pikërisht aty ku nisin kufizime për të mbrojtur të drejta të tjera, si mbrojtja e të dhënave personale, sekretit tregtar, sekretit shtetëror, të drejtën e autorit, etj. Në këto raste çështjet janë ideuar për t'iu nënshtruar edhe debatit gjyqësor, me synimin për të krijuar një praktikë të re, duke rivizatuar kufij më të favorshëm për të drejtën e informimit.

*Së fundi*, nga të dhënat e mbledhura nga aplikimet në Publeaks.al, edhe pse nuk përbën qëllim parësor të këtij raporti, janë parë me interes edhe aspekte që kanë të bëjnë me motivimin e qytetarëve për t'u informuar, të tilla si mosha e aplikantëve, arsimimi, gjinia, kategoria, objekti i kërkesave, etj.

# III TRANSPARENCA PROAKTIVE E INSTITUCIONEVE

## 3.1. Programet e transparencës

Qëllimi themelor i ligjit për të drejtën e informimit është të sigurojë një publik të informuar në një kohë sa më të shpejtë dhe një administratë llogaridhënese. Këto janë jetike për funksionimin e një shoqërie demokratike dhe paraqitet si domosdoshmëri për të sfiduar korrupsionin dhe për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve.


Një risi që solli ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ishte përfshirja e një detyrimi të ri për autoritetet shtetërore që të publikonin disa lloje informacionesh pa pasur nevojë për të dorëzuar kërkesë me shkrim. Këto informacione duhet të publikohen në mënyrë proaktive nga vetë autoriteti publik. Ideja ishte që afro 80% e informacioneve që kërkohen zakonisht, të ishin të aksesueshëm në internet me lehtësinë e një kliku. Duke vepruar kështu do të ulej numri i kërkesave dhe ankesave.

Res Publica ka monitoruar 100 autoritetet publike më të rëndësishme në vend, për 4 vjet rradhazi, për të vëzhguar në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e përmbushjes së programeve të transparencës. Sigurisht që publikimi i informacioneve të kësaj kategorie do të kërkonte kohë për të hapur rubrikat përkatëse dhe për të grumbulluar informacionin e duhur. Ligjvënësi caktoi një afat 6 mujor për autoritetet publike, por Komisioneri për të Drejtën e Informimit, duke qenë në kontakt me problemet reale, është treguar mirëkuptues për një kohë më të gjatë. Shpesh janë nevojitur trajnime për koordinatorët e të drejtës së informimit sepse kishte paqartësi në mënyrën se si duhej të zbatohet ligji.

Tashmë periudha aktuale e monitorimit, viti 2018, presupozohet ta gjejë terrenin të gatshëm me infrastrukturën e duhur dhe njohuritë e duhura, duke rritur natyrshëm pritshmëritë e të gjithë përdoruesve të të drejtës për t’u informuar.

Për të vlerësuar nivelin e transparencës përmes publikimit të informacioneve dhe dokumenteve nga institucionet me iniciativën e tyre, Res Publica monitoroi të gjithë detajet e programeve të transparencës dhe përditësimin e tyre për 100 institucione gjatë vitit 2018.

**Fig. 1 - Përmbushja e programeve të transparencës**



Nga të dhënat më sipër, rezulton se për vitin 2018 ka një ndryshim të lehtë, por jo domethënës në përmbushjen e programeve të transparencës, duke u reduktuar lehtë numri i institucioneve që nuk kanë program transparence dhe duke u shtuar pak numri i institucioneve që e kanë përmbushur kënaqshëm këtë program.

Mëgjithë përmirësimin e lehtë, situata mbetet shumë problematike sepse ende kemi një masë të madhe institucionesh pa program transparence. Madje, nga monitorimi është konstatuar se mbi 40% e këtyre rasteve nuk kanë as faqe interneti, duke lënë tërësisht në terr informativ publikun se çfarë po ndodh pas mureve të këtyre institucioneve.

Gjithashtu, problem përbën fakti që pjesa dërrmuese e institucioneve kanë përmbushur pjesërisht (më pak se gjysma) programet e transparencës. Pas katër vitesh, situata pritej të ishte shumë ndryshe, ndërkohë që progresi në këtë pikë është aq i ngadaltë sa duket se jemi përpara një situatë të frenuar në shifra mediokre.

Përsa i përket përmbajtjes, në fund të vitit 2017 vihej re një përmbushje mesatare prej 26% e programeve të transparencës, ndërsa në fund të vitit 2018, pra një vit më vonë, përmbushja është në nivelin 24%, pra ka një rënie të lehtë, pavarësisht se 7% e institucioneve kanë siguruar një përmbushje më të mirë të këtij detyrimi, për shkak të mospërditësimit të të dhënave.

Një ndër rekomandimet e bëra nga Qendra Res Publica ndër vite ka qenë miratimi i modeleve specifike të programeve të transparencës, të përshtatur sipas natyrës dhe kompetencave të cdo institucioni. Për shembull institucionet që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështje mjedisore duhet të pasqyrojnë në programet e transparencës çdo informacion mbi veprimtaritë me impakt në mjedis, sipas kërkesave specifike që kërkon legjislacioni përkatës. Shumë organizata dhe aktivistë për të drejtat e mjedisit ankohen për mospublikimin e këtyre informacioneve që pasohet me mosreagimin në kohën e duhur dhe lejimin e dëmeve të parikthyeshme në mjedis. Në këto raste, modeli i programit të transparencës duhet për përmbajtje detyrimin konkret për të publikuar këto informacione jetike, dhe mospublikimi i tyre duhet të shoqërohet me një sanksionim të rreptë nga ana e Komisionerit.

Ky rekomandim është marrë parasysh nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, por i shtrirë në pak institucione. Me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e programit model

të transparencës për njësitë e qeverisjes vendore”, Komisioneri kërkon nga institucionet e qeverisjes vendore, Bashkitë, që të plotësojnë dhe të zbatojnë këtë program brenda datës 01.01.2019.

Nga monitorimi i programeve të transparencës rezulton që vetëm 5% e institucioneve kanë modele të veçanta për transparencën e institucionit (rubrika të veçanta), ndërsa 57% e institucioneve kanë të njëjtin model transparence që nga viti 2015 dhe shpeshherë ky model as nuk është përditësuar me informacione të reja gjatë viteve, duke u bërë tërësisht joeficient.

Vihet re se në masën dërrmuese në programet e transparencës, qoftë edhe në ato raste kur rubrika është përmbushur jo keq, mungojnë informacione që vërtet kanë vlerë për t'u publikuar ku spikat mangësia pothuajse totale e informacionit për monitorimin e kontratave të prokurimit publik dhe/ose koncesioneve.


Një tjetër aspekt që është vënë re gjatë monitorimit është dhe mënyra e plotësimit të këtyre programeve, si psh. duke vendosur vetëm linkun referues për gjetjen e një informacioni të caktuar, por ai nuk funksionon.

Kjo situatë, ku nga njëra anë paraqet një progres të pjesshëm dhe pa ndonjë vlerë, dhe nga ana tjetër paraqet një relaksim të papranueshëm të shumë institucioneve të tjerë, duhet të ngrëjë flamuj të kuq për Komisionerin për të Drejtën e Informimit, i cili duhet të marrë masa konkrete dhe energjike për të ushtruar presion ndaj personave përgjegjës që duket se nuk kanë asnjë motivim për të zbatuar detyrimet minimale që rrjedhin nga ligji.

### 3.2. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Mbajtja e një regjistri të posaçëm ku pasqyrohen kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre është një detyrim që parashikohet nga neni 8 i ligjit për të drejtën e informimit. Ky regjistër shërben për të lehtësuar marrjen e informacionit nga çdo kërkuar, në rast se dikush tjetër ka kërkuar më parë po të njëjtin informacion, pa pasur nevojë për të bërë një kërkesë të re. Kjo gjë nga njëra anë lehtëson aksesin e qytetarëve për informim e nga ana tjetër i shërben edhe vetë institucionit i cili ekonomizon kohën dhe energjitë duke mos kthyer përgjigje disa herë për të njëjtën çështje.

Fig. 2 - Përmbushja e regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve




Nga grafiku i mësipërm, rezultojnë një situatë alarmante, ku institucionet që kanë plotësuar të gjitha kërkesat për regjistrin, mbetet në nivelin tërësisht të papranueshëm, prej 1%. Përveç vetë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, asnjë institucion tjetër nuk ka plotësuar kërkesat ligjore.

Ndërkohë, nëse hedhim një vështrim mbi përmbushjen pjesërisht të kërkesave të ligjit, viti 2018 paraqitet me përmirësime të parëndësishme. Për shembull, 7% e institucioneve që deri vitin e kaluar nuk kishin fare një regjistër, sot e kanë, por vetëm formalisht. Ky lloj “përmirësimi” është tërësisht i parëndësishëm, nëse kemi parasysh qëllimin e publikimit të regjistrit, që është aksesimi në informacionet e dhëna më herët. Në fund të fundit askujt nuk i intereson nëse ekziston një regjistër nëse ai nuk ka të dhëna, apo ka të dhëna që paska pasur kërkesa por nuk dihet se çfarë përgjigjesh janë dhënë.

### 3.3. Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit

Caktimi i një koordinatori për të drejtën e informimit është një detyrim ligjor, me qëllim lehtësimin e procesit të marrjes së informacionit, dhe ngarkimin e përgjegjësive një zyrtari konkret. Sigurisht që nuk mjafton vetëm caktimi i tyre që puna të shkojë mirë. Ata duhet të kenë profilin e duhur dhe të marrin trajnimet e nevojshme. Këto të fundit nuk janë të dhëna të matura në këtë studimin sepse janë ezauruar nga një studim tjetër i bërë nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit<sup>1</sup>.

*Fig. 3 - Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit*



Nga grafiku i mësipërm, rezultojnë që caktimi i koordinatorëve ka mbetur në të njëjtin nivel me një vit më parë, me një ndryshim të papërfillshëm. Ky fakt është shqetësues që edhe pas 4 vitesh nuk po merren masat që institucionet të paktën të kenë caktuar formalisht koordinatorët. Konkretisht edhe në vitin 2018 vihet re se ende 1/4 e institucioneve nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit ose të paktën nuk e kanë bërë këtë gjë publike.

Megjithë përpjekjet e bëra, rezultojnë se trajnimet e koordinatorëve nuk janë më nevojë primare, por shpërfillja e institucioneve që të respektojnë minimumin e kërkesave ligjore është një sjellje për t'u marrë seriozisht me të.

Përsa i përket publikimit të kontakteve të koordinatorëve, vihet re se ato janë publikuar në të gjitha rastet.

<sup>1</sup> <https://pyetshtetin.al/raport-vleresimi-i-kapaciteteve-te-koordinatorëve/>

# IV REAGIMI I INSTITUCIONEVE NDAJ KERKESAVE PER INFORMACION

Res Publica ka vijuar edhe për vitin 2018 testimin e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave për informacion. Gjatë këtij viti, Qendra Res Publica u ka dërguar institucioneve të ndryshme 254 kërkesa për informacion, dhe për të krahasuar gjetjet e këtij viti me ato të mëparshmet. Janë përzgjedhur 202 kërkesa me qëllim bërjen e një krahasimi të drejtë me vitet e mëparshme. Konkretisht është synuar të përzgjidhen kërkesat që kanë përfunduar në të gjitha etapat.

Për efekt të këtij studimi janë monitoruar të njëjtët komponentë me studimet e mëparshme, dhe konkretisht:

- Fusha e informacionit të kërkuar
- Kategoria e institucioneve të pyetur
- Sasia dhe cilësia e përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare
- Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ te Komisioneri
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas depozitimit të ankimit administrativ

## 4.1. Fusha e informacionit të kërkuar


Fushat në të cilat është kërkuar informacion janë të larmishme, si më poshtë:

- Konsultimit publik
- Drejtësia
- Financat
- E drejta e konsumatorit
- Mjedisi
- Arsimi
- Marrëdhëniet e punës
- Prokurimet
- Auditimet
- Kultura

## 4.2. Kategoria e institucioneve të pyetur

Në lidhje me kategoritë e institucioneve që u janë drejtuar kërkesat, situata paraqitet si më poshtë:

*Fig. 4 - Kërkesat sipas kategorive të institucioneve*




Përzgjedhja e institucioneve të pyetura varet nga kërkesat e qytetarëve që kanë aplikuar përmes Publeaks.al Interes më të madh është treguar për pushtetin vendor, pasi këto institucione janë zakonisht më pranë qytetarëve, arsyet mendohet të jenë të lidhura me impaktin e veprimtarisë së këtyre institucioneve më të drejtpërdrejtë në interesat e jetës së përditshme të tyre.

## 4.3. Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare

Situata e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave fillestare për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

*Fig. 5 - Përgjigjet e kthyer pas kërkesës fillestare*





Nga 202 kërkesa drejtuar institucioneve, janë kthyer përgjigje në 144 raste. Përgjigje të plota kanë qenë vetëm në 94 raste, ndërsa në 50 raste të tjera, përgjigjet kanë qenë të pjesshme dhe shpesh formale.


E shprehur me përqindje, kërkesat fillestare për informacion kanë marrë përgjigje të plota vetëm në 46% të rasteve, krahasur me 63% të rasteve në vitin 2017, por njëjloj me vitet e mëparshme.

Këto të dhëna tregojnë se kemi një regres të situatës. Një nga arsytet e mundshme është edhe interesi më i madh i kërkuesve për çështje sensitive, fakt i konstatuar gjatë hartimit të kërkesave.

Afro një e treta e institucioneve vazhdojnë sjelljen refuzuese ndaj kërkesave për informacion. Mosmarrja e masave nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit ndihmon në mënyrë të vazhdueshme stanjacionin në disa parametra dhe regresin në tërësi.

#### 4.4. Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

*Fig. 6 - Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesës fillestare (në ditë kalendarike)*



Sipas grafikut të mësipërm rezulton se kohëzgjatja mesatare e kthimit të përgjigjeve për kërkesat gjatë vitit 2018 ka arritur një rekord negativ, konkretisht dy herë më shumë se mesatarja e matur në vitin 2017. Njëkohësisht kjo është situata më e keqe në 4 vitet e fundit. Madje, tejkalon edhe rekordin negativ historik të matur nga Res Publica në vitin 2013, kur kjo mesatare ishte 24 ditë kalendarike.

Në këtë pikë, për këtë parametër, është njëjloj sikur të mos ketë fare një ligj të ri, që për më tepër raportohet si ligji më i mirë i renditur në vendin e 6 në botë, i cili reduktoi afatin nga 40 ditë kalendarike në 10 ditë pune.

Theksojmë se afati ligjor prej 10 ditësh pune (zakonisht 14 ditë kalendarike) është afat maksimal. Edhe sikur ky afat të respektohej nga institucionet, nuk duhet të ishim të kënaqur, pasi presupozohet se afati maksimal është vendosur nga ligjvënësi për të përballuar edhe ndonjë rast kompleks, ku dhënia e informacionit nuk mund të jepet për pak ditë. Pra edhe më e rëndë është situata nëse pikërisht kohëzgjatja e përgjigjeve është dyfishuar sepse në fund të fundit, dhënia e informacionit ka vlerë të jepet sa më shpejt.


Në përgjithësi mund të themi se për vitin 2018, edhe kur nuk është refuzuar dhënia e informacionit, ai është dhënë dukshëm përtej afatit maksimal të caktuar me ligj.

Këto të dhëna duhet të shërbejnë si një kampion alarmi për Komisionerin për të Drejtën e Informimit, si institucioni përgjegjës për zbatimim efektiv të ligjit për të drejtën e informimit.

#### 4.5. Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ

Në lidhje me reagimin e institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ, situata paraqitet si më poshtë:

**Fig. 7 - Përqindja e përgjigjeve pas dorëzimit të ankimit administrativ**



Siç rezulton nga grafiku i mësipërm, kemi një rritje të reagimit në këtë fazë, ku pjesa dërrmuese e institucioneve kanë kthyer përgjigje pas ankimit, ende pa marrë Komisioneri një vendim. Komisioneri ka marrë vendim detyrues për dhënien e informacionit në 6 raste, prej të cilave në dy raste përgjigja është kthyer, ndërsa në katër rastet e tjerë përgjigja nuk është kthyer ende. Madje dy prej tyre janë ankuar në gjykatë kundër Komisionerit ndërsa dy rastet e tjerë janë duke u ndjekur në rrugë gjyqësore nga Res Publica.

Siç rezulton nga më lart, pavarësisht se shumë institucione e marrin seriozisht detyrimin pas ankimit, në disa raste nuk mjafton vetëm ankimi te Komisioneri që të vihet çështja në rrugën e zgjidhjes, por institucionet mund të qendrojnë “kokëfortë” deri në fund, madje edhe pas Vendimit të Gjykatës në ndonjë rast<sup>2</sup>.

Në këto kushte lind detyrimi të ritheksojmë “deri në bezdi”, që marrja e masave administrative (gjobat) janë të domosdoshme në rrethana të caktuara.

Ankimi ndaj Vendimit të Komisionerit në gjykatë nga institucionet e detyruara për dhënien e informacionit përdoret shpesh si një artificë ligjore, e cila shfrytëzohet për mos ta dhënë


<sup>2</sup> Shembull: Ministria e Mbrojtjes edhe pas Vendimit të Gjykatës nuk ka dhënë informacion lidhur me Kopje të studimit: “Vlerësimi paraprak i riskut mjedisor të eksplozivëve në Fabrikën Mjekës, Shqipëri”

informacionin, edhe kur organi i krijuar me ligj për garantimin e dhënies së informacionit vlerëson dhe vendos që informacioni duhet të jepet. Mes këtyre manovrave, këto institucione, edhe pse të ndërgjegjshme që vendimi i Gjykatës nuk do jetë në favor të tyre, fitojnë kohë për të mos e dhënë informacionin, dhe kjo strategji vlen më shumë po të kemi parasysh se vendimi i gjykatës do të marrë formë të prerë pas mesatarisht 3 vjetësh (kohëzgjatja normale e shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit). Pas kaq kohësh, informacioni i kërkuar humbet tërësisht vlerën dhe sidomos gazetarët nuk kanë interes më për këtë informacion pasi humbet aktualitetin. Është kjo arsyeja pse edhe në studime të mëparshme kemi kërkuar veç bërjes së vendimit të komisionerit titull ekzekutiv edhe një ndërhyrje tjetër në ligjin për gjykatat administrative, ku vendimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këto lloj çështjesh të jenë të paankimueshëm, njëlloj si vendimet e gjykatës për gjobat me vlera të vogla.

#### 4.6. Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ

Në lidhje me kohëzgjatjen e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ, krahasuar me vitet e mëparshme, situata paraqitet si më poshtë:

*Fig. 8 - Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ*



Edhe ky grafik vizualisht evidenton se treguesit për vitin 2018 janë në rënie alarmante. Kohëzgjatja mesatare është rritur dyfish krahasuar me vitin e kaluar. Ky tregues shpreh vetëm të dhënat për rastet kur institucionet e japin vetë informacionin pas ankimit të Komisioneri, por pa u dhënë vendim nga ky i fundit. Siç e trajtojmë në kapitullin përkatës, vetë Komisioneri e ka tejkaluar afatin ligjor me afro 2.5 herë në vitin 2018, duke dhënë vendime për mesatarisht 54 ditë, ndërsa në 4 raste vendimi është dhënë pas më shumë se 100 ditësh. Kështu duket se kjo zvarritje incentivon institucionet të reagojnë gjithnjë e më ngadalë.



# V VLERESIM I PUNES SE KOMISIONERIT PER TE DREJTEN E INFORMIMIT

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni që kujdeset për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Për këtë arsye veprimtaria e këtij institucioni ka qenë në fokusin e monitorimit nga Res Publica, që nga momenti që ka hyrë në fuqi ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndonëse Komisioneri ka ndërmarrë vazhdimisht nisma për të trajnuar nëpunësit e administratës për detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit, si dhe ka krijuar një praktikë të mirë të interpretimit të aspekteve të ndryshme të ligjit, ai ka pasur një qasje të butë ndaj fenomeneve negative dhe nuk ka arritur të garantojë zbatimin e ligjit në mënyrë efektive dhe në përputhje me pritshmëritë e ligjvënësit dhe shoqërisë civile.

Kjo situatë vjen edhe për shkak të disa mangësive që ka ligji për të drejtën e informimit dhe për këtë arsye janë ndërmarrë dhe nisma për të bërë disa amendime. Por qasja e butë e Komisionerit ndaj rasteve të refuzimit të ndërgjegjshëm të dhënies së informacionit, apo tolerancat ndaj vonesave në përgjigje dhe ndaj përgjigjeve të paplota, duke u treguar tepër mirëkuptues me shkelësit, ka sjellë zbutjen e forcës reale që ka ligji, megjithë mangësitë e tij.


Res Publica ka vijuar monitorimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe për vitin 2018, dhe mund të ofrojë krahasimin me periudhat e mëparshme.

Një pjesë e të dhënave janë marrë nga faqja e internetit e Komisionerit, ndërsa pjesa tjetër është marrë nga përgjigjet e kërkesave për informacion drejtuar zyrës së tij.

Është për të theksuar se në fokus kemi pasur punën e kësaj zyre në trajtimin e ankesave dhe monitorimin e programeve të transparencës si detyrime ligjore, duke lënë jashtë vëmendjes veprimtaritë promovuese, trajnimet dhe projektet e ndërmarra nga Komisioneri, si të një rëndësie që nuk na takon ta vlerësojmë.

## 5.1. Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

*Fig. 9 - Numri i ankesave drejtuar Komisionerit në vite (2015 – 2018)*



Nga krahasimi i të dhënave më sipër rezulton që numri i ankesave drejtuar Komisionerit për vitin 2018 është rritur në mënyrë të ndjeshme, me 38 % më shumë, krahasuar me vitin 2017. Viti 2018 shënon numrin më të lartë të ankesave në këto 4 vite.


Kjo rritje mund të vijë për disa arsye, për shembull: publiku mund të jetë më i ndërgjegjësuar për të ndjekur të gjitha mundësitë ligjore, deri në sigurimin e informacionit; numri i kërkesave për informacion mund të jetë rritur, duke sjellë si pasojë edhe shtimin e numrit të ankesave; refuzimi i dhënies së informacionit mund të jetë më i lartë në vitin 2018 në tërësi. Në kushtet kur nuk i kemi të dhënat për të dalë në një përfundim të saktë, morëm në konsideratë raportin e numrit të kërkesave të dërguara nga vetë Res Publica në këto dy vitet e fundit me numrin e refuzimeve ose përgjigjeve të paplota. Kuptohet që mospërgjigjet ose përgjigjet e paplota janë baza e zakonshme për të bërë ankim te Komisioneri.

Rezultoi se në vitin 2018, Res Publica është përballur me një rritje prej 38% të nevojës për ankim, e cila koïncidon me rritjen prej 38% të numrit total të ankesave që kanë mbërritur Komisionerit në adresën e tij. Kjo përputhje jep idenë, ndonëse jo në mënyrë përfundimtare dhe bindëse, se rritja e numrit të ankesave pranë Komisionerit mund të ketë ardhur për shkak të uljes së përqindjes të përgjigjeve të plota nga autoritetet.

## 5.2. Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Komisioneri, si dhe në informacionet e marra në rrugë zyrtare, nëse do i referoheshim kategorisë së subjekteve që i janë drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit situata paraqitet si më poshtë:

**Fig. 10 - Kategoritë e subjekteve ankimues**




Nga të dhënat e pasqyruara në grafikun më sipër rezulton se nuk ka ndryshim thelbësor të numrit të gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile që kanë bërë ankim te Komisioneri gjatë vitit 2018 në raport me vitin e kaluar. Ndërkohë, është për tu vlerësuar fakti se edhe gjatë këtij viti është konsoliduar më shumë vendi i parë që e zënë qytetarët, të cilët interesohen për çështje publike për interesa të ndryshme, jo të lidhura domosdoshmërisht me fushën e aktivitetit të tyre siç janë organizatat e shoqërisë civile, të cilët veprojnë në interes të projekteve të ndryshëm të monitorimit, apo edhe gazetarë që sërish kërkojnë informacion në funksion të aktivitetit të tyre profesional. Nëse konsiderojmë që gjysma e ankesave të paraqitura te Komisioneri janë nga Res Publica, e cila merr shkas nga kërkesat e qytetarëve përmes platformës Publeaks, numri i qytetarëve të angazhuar duket se është më i madh.

### 5.3. Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

Vendimet e marra nga Komisionerit ndër vite paraqiten si më poshtë:

**Fig. 11 - Numri i vendimeve të Komisionerit në vitet 2015- 2018**




Nga të dhënat më sipër rezulton që për vitin 2018 numri i vendimeve të marra nga Komisioneri është ulur ndjeshëm megjithëse ky është viti me numrin më të lartë të ankesave.

Gjatë vitit 2018, Komisioneri ka marrë vendim vetëm për 4.9% të ankesave, krahasuar me vitin 2017 ku kjo e dhënë ishte 11.3%. Ankesat e tjera janë zgjidhur përmes praktikës së “zgjidhjes me mirëkuptim”, e promovuar nga Komisioneri si një mjet efektiv, pavarësisht se ligji nuk e parashikon. Kjo praktikë, në vlerësimin tonë, ndonëse ka rritur numrin e përgjigjeve në këtë fazë, nuk i shërben më rritjes së efektivitetit të zbatimit të ligjit, por përkundrazi, ajo sjell vonesë të tepërt në dhënien e informacionit, shmangie nga sanksionet duke keqedukuar shkelësit përsëritës, si dhe moskonsolidim të praktikës për shkak të numrit të ulët të vendimeve.

#### 5.4. Llojet e vendimeve të marra nga Komisioneri

*Fig. 12 - Llojet e vendimeve të Komisionerit*



Grafiku i mësipërm sugjeron se nuk ka ndryshime në llojin e vendimmarrjes së Komisionerit. Vazhdojnë të dominojnë vendimet pozitive të pranimit të plotë të ankesës. Numri i refuzimeve është i vogël çka paraqet se ankesat përgjithësisht janë të bazuara dhe kjo dukuri është e evidente në të tre vitet e fundit.

#### 5.5. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri


Këtë vit Res Publica ka matur edhe një parametër të ri që është kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Sipas ligjit, Komisioneri duhet të marrë vendime prej 15 ditëve pune. Madje ligji parashikon që në rast se Komisioneri nuk shprehet brenda këtij afati, atëherë ankuesit i lind e drejta që ti drejtohet gjykatës.

Në fakt, situata paraqitet ndryshe dhe problematike.



**Fig. 13 - Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve të Komisionerit**




Në grafikun e mësipërm vihet re se vetëm një pjesë e vogël e vendimeve janë marrë brenda afatit ligjor. Vendimmarrja jashtë afatit ligjor ka ndodhur në 92% të rasteve, njëlloj në të dy vitet e fundit. Madje kohëzgjatja në disa raste ka shënuar mbi 100 ditë.

Mesatarja e kohëzgjatjes në këtë vit është 54 ditë kalendarike, ose rreth 2 herë e gjysëm më shumë se kufiri maksimal ligjor. Edhe vjet situata ka qenë e ngjashme, me një mesatare prej 57 ditësh. Siç vihet re edhe nga grafiku, kohëzgjatja më normale është rreth 40-60 ditë kalendarike, duke vjetëruar informacionin tej mase, deri sa ai rrezikon të jetë i papërdorshëm.

Kjo kohëzgjatje vjen edhe nga modus operandi që Komisioneri ka përshtatur ndër vite, duke i bërë fillimisht shkresa institucioneve për t’iu kujtuar atyre detyrimet e ligjit, duke dërguar inspektorë për të bërë verifikime, duke organizuar seanca dëgjimore të cilat kërkojnë kohë të njoftohen dhe organizohen, duke i lënë afate të dyta, etj, pra shumë hapa me pasojë vonesën e dhënies së informacionit dhe humbjen e praktikitetit të ligjit.

### 5.6. Aplikimi i sanksioneve

**Fig. 14 - Numri i gjobave të vendosura nga Komisioneri**



Numri i gjobave edhe në këtë vit është shumë i vogël dhe i pandjeshëm në raport me shkeljet. Përveç faktit që Komisioneri ka marrë vendime pozitive në mbi 30 raste, nuk duhet anashkaluar fakti që janë paraqitur 755 ankesa dhe vendosja e vetëm 4 gjobave e rrit pandëshkueshmërinë në nivele të larta. Qasja e Komisionerit vazhdon të jetë e njëjta, duke synuar edukimin përmes vendimeve të mira, trajnimeve, seancave dëgjimore, aktiviteteve publike promovuese për të drejtën e informimit, por me sa më pak ushtrim force ndaj shkelësve. Nëse mund të jetë e pranueshme kjo qasje në momentet e para, kur ligji i ri nuk ishte ende i njohur, pas 4 vitesh nuk mund të pretendohet më që edukimi vjen vetëm përmes frymëzimit e ndërgjegjësimit, por edhe përmes forcës që ligji i ka dhënë ekskluzivisht këtij institucioni.

Është e pritshme të paktën që gjobat të vendosen ndaj shkelësve përsëritës, siç është rasti i Bashkisë Tiranë, kundër së cilës janë dhënë 3 vendime detyrimi për dhënie informacioni në vitin 2018 dhe 4 vendime të tilla, në vitin 2017, por nuk është vendosur asnjë gjobë. Ndërkohë rezulton që të jetë vendosur gjobë ndaj një institucioni që Komisioneri është shprehur vetëm një herë me vendim detyrimi për dhënie informacioni, siç është Drejtoria e Përgjithshme Detare. Nëse shtojmë këtu edhe faktin se në raportin e vitit të kaluar Res Publica ngrinte shqetësimin se Komisioneri nuk merrte dot vendim ndaj Kryeministrit dhe kishte lënë pezull disa çështje, fakti që edhe ndaj Bashkisë Tiranë, Komisioneri mban një qendrim të butë, sugjeron që ai ndoshta nuk ka forcën e duhur të përballet me institucione që kontrollohen nga persona të rëndësishëm për forcën politike që dominon Kuvendin, prej të cilit varet edhe mandati i ri i Komisionerit që do të votohet në 2019. Në këtë kontekst do të duhet të mendohet një skemë për rritjen e pavarësisë së këtij organi.

Gjobat e vëna janë fokusuar te shkeljet e refuzimit të përgjigjes, moszbardhjes së informacionit, pengimin e koordinatorit për dhënien e informacionit. Nuk ka raste gjobash për mosplotësimin e programeve të transparencës. Ndërkohë që në njërin anë përmbushja e programeve të transparencës është në nivele tepër të ulëta, nga ana tjetër mosmarrja e asnjë masë me sanksion ndaj shkelësve, ka ndikuar në mënyrë të tërthortë te rritja e kërkesave për informacion dhe për rrjedhojë edhe te rritja e ankesave. Nëse Komisioneri do të ndiqte një politikë më energjike për plotësimin e programeve të transparencës, automatikisht do të kishte më pak kërkesa për informacion dhe do të ulej numri i ankesave, duke ulur ngarkesën e vetë Komisionerit, i cili dukshëm merr pak vendime, dhe ato i merr jashtë afatit. Do të ishte e arsyeshme që lufta të fokusohet te goditja e dukurive problematike që në gjenezë, duke luftuar fort për plotësimin e programeve të transparencës dhe kjo luftë nuk mund të jetë e fortë pa goditjen me sanksione.

### 5.7. Seancat dëgjimore

Seancat dëgjimore zhvillohen nga Komisioneri për raste komplekse, ku diskutohen arsyet e refuzimit të dhënies së informacionit apo ku e drejta për informim shkel shumë pranë kufirit ndarës ku nis një e drejtë tjetër.

Gjatë vitit 2018, nga 37 raste ku Komisioneri është shprehur me Vendim, në 16 prej tyre ai ka zhvilluar një seancë dëgjimore më parë. Ky është një numër i lartë që ndoshta vjen edhe për shkak të rasteve kur informacioni ka qenë sensitiv dhe institucioni është munduar të argumentojë mosdhënien e tij, duke përdorur një argumentim ligjor potencialisht të vlefshëm.

Fakti i numrit relativisht të lartë të seancave dëgjimore vjen edhe për shkak të fokusit të Komisionerit te një vendimmarrje cilësore, gjë e cila duket se është realizuar dhe është për t'u vlerësuar. Nga studimi i Vendimeve të Komisionerit, duket qartë që ato janë të mbështetura dhe të analizuar mirë. Megjithatë kjo nuk duhet të bëhet pengesë për të rritur numrin e tyre dhe shpejtësinë e marrjes së tyre.

# VI ÇESHTJE ME INTERES TE VEÇANTE LIDHUR ME TË DREJTEN E INFORMIMIT

Qendra Res Publica përveç monitormit të zakonshëm të veprimtarisë së autoriteteve publike në kuadër të respektimit të së drejtës për informim, gjatë kësaj periudhe ka vijuar të merret me aspekte të veçanta lidhur me të drejtën e informimit, sidomos kur këto çështje shtrojnë debate juridike, që përfshijnë përplasjen mes të drejtës së informimit dhe të drejtave të tjera.

Në praktikë ndodh shpesh që institucionet të keqinterpretojnë dispozitat në lidhje me kufizimin e së drejtës për tu informuar, për të cilat nevojitet një debat i shëndoshë juridik, duke angazhuar organet administrative (Komisionerin për të Drejtën e Informimit) dhe ato gjyqësore (Gjykatën Administrative).

## 6.1. Publikimi i informacioneve për vendimmarrjet me impakt në mjedis

Degradimi mjedisor në Shqipëri është diçka që është raportuar vazhdimisht nga gazetarë, aktivistë, studiues të fushës. Nëse publiku nuk informohet nuk ka se si të mbrohet në rast të shkeljeve të të drejtave të tij, në mënyrë efektive dhe në kohën e përshtatshme, ndaj e drejta e informimit është një nga të drejtat bazë që legjislacioni i njeh publikut veçanërisht e lidhur me çështjet mjedisore, madje në këtë rastin e fundit e ka ngritur këtë të drejtë specifikisht në nivel kushtetues, por e mbrojtur edhe nga akte ndërkombëtare. Legjislacioni shqiptar, në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, ka parashikuar të drejtën e qytetarit për t'u informuar, për tu konsultuar, lidhur me hartimin/miratimin e akteve për çështjet mjedisore që në fazat e hershme të një propozimi për investime me impakt në mjedis. Rëndësi ka edhe informimi vazhdues në të gjitha fazat e procesit dhe gjatë monitorimit të tij. Dhënia e këtij informacioni nuk duhet të vonohet, pasi mundëson që aktet e dala në secilën fazë të fitojnë “imunitet” nga ankimet për shkak të kalimit të afateve ligjore, të cilat janë relativisht të shkurtra. Informimi në kohë garanton që ankimi të bëhet në kohë të duhur dhe të “piqet” mirë nga organizatat dhe grupet e interesit.

Madje informimi në çështje mjedisore vjen si detyrim ligjor të bëhet në mënyrë proaktive në afate dhe kushte të rregulluara me detaje nga akte nënligjore.

Ajo që kemi vënë re gjatë studimit, por edhe gjatë aktivitetit tonë në çështje të tjera, është se informimi në çështje mjedisore jo vetëm nuk vihet në dispozicion në mënyrë proaktive nga institucionet, por ai refuzohet rregullisht kur ai kërkohet, sidomos në rastet e investimeve private, ku mund të themi se interesat e këtyre biznesieve e mbajnë peng informacionin.

Kjo problematikë ka rezultuar edhe gjatë një studimi të bërë më herët nga Res Publica për paditë mjedisore<sup>3</sup>.

Duke e konsideruar të një rëndësie parësore informimin dhe konsultimin në çështjet mjedisore, i kemi kushtuar rëndësi trajtimit më vete të kësaj çështjeje, duke bërë disa testimet dhe kërkime si ai në vijim.

Më konkretisht, si fillim hulumtuam në faqet e internetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë së Mjedisit, Bashkisë Tiranë (e përzgjedhur si Bashkia më e madhe në vend), ku rezultoi se asnjë nga këto institucione nuk informonin publikun mes faqeve të tyre, siç kërkohet nga VKM nr. 247, dt 20.05.2014 “Për përcaktimin e rregullave të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

Në të njëjtën mënyrë nuk publikoheshin as dokumentet bazë, të lidhura me çështjet mjedisore në një procedurë zhvillimi, siç janë Projektet e Fizibilitetit, Kontratat Konkensionare, Deklaratat Mjedisore, Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimet Strategjike Mjedisore. Këto të fundit janë dokumentet bazë, të cilat duhet të konsultohen që në fazën paraprake të draftimit të tyre dhe deri në miratimin e tyre. Është pikërisht rëndësia që ato kanë arsyeja pse legjislacioni kërkon bërjen publike të tyre, sipas afateve dhe procedurave të mirë përcaktuara në ligj. Nga kjo rezultoi se organet përgjegjëse nuk i respektojnë kërkesat dhe cenojnë garancitë ligjore lidhur me informimin. Duke parë këtë situatë, iu drejtuam me një kërkesë Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit për t’i kujtuar asaj detyrimin për bërjen publike të këtyre informacioneve. Njëkohësisht të njëjtin shqetësim e ndamë përmes një memoje me deputetët, anëtarë të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit pranë Kuvendit të Shqipërisë. Nisur nga përgjegjësia e Ministrit të Mjedisit, jo vetëm si organ politik, por edhe si organi që VKM nr. 247, dt. 10.05.2014 e ka ngarkuar me shqyrtimin e ankesave në rast të mosrespektimit të kësaj VKM-je duke mos bërë publike informacionet në fjalë, iu drejtuam atij me një ankesë.

Në përgjigje të ankesës sonë, Ministri i Mjedisit iu drejtua me shkresë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit duke i kujtuar kësaj të fundit detyrimet që ajo ka për publikimin e informacioneve të renditura në ankesën tonë. Bën përshtypje mungesa e vullnetit të kësaj Ministrie për ta zgjidhur realisht çështjen duke mos u interesuar së pari nëse është apo jo i vërtetë fakti se këto informacione realisht nuk publikohen dhe së dyti nëse një gjë e tillë konfirmohet e vërtetë, Ministri nuk e përdori autoritetin që i jep ligji të kërkonte llogari për faktin se pse këto informacione nuk publikohen dhe as nuk bëri përpjekje të merrte masa të forta për publikimin e këtyre informacioneve në të ardhmen, duke e monitoruar madje këtë proces.

Më tej, duke u bazuar në kompetencat që i janë dhënë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, lidhur me publikimin e informacioneve pa kërkesë, iu drejtuam këtij të fundit duke i kërkuar zgjidhjen e dy çështjeve:

Së pari, të hetojë për arsyet e mospublikimit në faqen zyrtare të informacioneve që ligji kërkon të bëhen publike pa kërkesë dhe;

Së dyti, të modifikojë modelin e programit të transparencës, për ta bërë atë të përshtatshëm për organet që janë të ngarkuara nga legjislacioni që rregullon fushën e mjedisit për publikimin e dokumenteve të veçanta lidhur me mjedisin, konkretisht për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Në përgjigjen e tij, Komisioneri u shpreh se ndan të njëjtin mendim në lidhje me përditësimin e programeve të transparencës<sup>4</sup> me informacione specifike mjedisore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Për këtë qëllim Komisioneri iu drejtua këtyre autoriteteve me shkresë duke i kërkuar atyre;

- Të informojnë publikun gjatë procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Të informojnë, të bëjnë konsultime dhe dëgjesa publike gjatë procedurës së thelluar të VNM-së sipas kreut II të VKM nr. 247/2014;
- Të informojnë publikun gjatë monitorimit e ankimit sipas Kreut III të VKM nr. 247/2014;
- Të publikojnë çdo informacion tjetër që lidhet me çështjet e mjedisit dhe përbën interes të lartë publik. Gjithashtu Komisioneri organizoi një trajnim me këto autoritete publike lidhur me aksesin në informacionin mjedisor.

Edhe pas këtyre veprime të Komisionerit, situata mbetet e pandryshuar. Më 04.07.2018 AKM miratoi një program të ri transparence, por nuk reflektoi kërkesat e Komisionerit. Ndërkohë programi shfaqet vetëm si një dokument i skanuar pa ndonjë vlerë. Nuk kemi dijeni që Komisioneri të ketë përdorur mjetet penalizuese ndaj këtyre institucioneve, gjë e cila është domosdoshmëri dhe e vetmja rrugë për të siguruar informimin mbi aktivitetin e administratës në çështjet me impakt në mjedis.

## 6.2. Mospublikimi i vendimeve gjyqësore

Me Udhëzimin nr. 4059/2 datë 07.06.2016 të Ministrisë së Drejtësisë *“Për anonimizimin e të dhënave personale të vendimeve gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”*, i cili është mbështetur dhe në rekomandimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>5</sup>, janë marrë masa për kufizimin e aksesit në të dhënat mbi dosjet gjyqësore që publikohen në faqet zyrtare të gjykatave. Kufizimi përfshin mospublikimin e emrave të palëve ndërgjyqëse, objektit të mosmarrëveshjes, si dhe prek edhe vetë vendimet e gjykatave.

Res Publica ka mbajtur qëndrimin që ky udhëzim cenon të drejtën për informim dhe është në kundërshtim me parashikimet në Kushtetutë (vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast) dhe me Kodet e Procedurës Civile dhe Penale (seancat janë publike). Njësoj janë shprehur edhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

4 Programet e transparencës përmban informacione që duhet të vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë të veçantë nga publiku, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

5 Rekomandimi nr. 8, datë 5.6.2013, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Komisioneri për të Drejtën e Informimit në disa vendime ka mbajtur qëndrimin se:

*“...qëllimi i këtij udhëzimi nuk është pengimi i transparencës dhe kufizimi i së drejtës së informimit, lidhur me vendimet gjyqësore, por përcaktimi i detyrimeve të gjykatave në cilësinë e autoritetit publik në garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në to, si një e drejtë themelore e barazplefshme me të drejtën e informimit...”<sup>6</sup>.*

Në pamje të parë duket se ka një përplasje mes dy qëndrimeve të Komisionerit, ku nga njëra anë ky i fundit si garantues i mbrojtjes së të dhënave personale ka nxjerrë një rekomandim që “detyron” gjyqësorin të kufizojë publikimin e vendimeve dhe nga ana tjetër po Komisioneri, si garantues i së drejtës për informim, arsyeton se vendimet e gjykatës duhet të publikohen.

Në vështrimin tonë rekomandimi i Komisionerit është interpretuar gabimisht në disfavor të së drejtës së qytetarëve, për t’u njohur me vendimet e gjykatës, të cilat duhet të jenë publike, ndaj sugjerojmë që vetë Komisioneri, i cili kryen njëherazi të dy funksionet të qartësojë qëndrimin e vet, qoftë mes një rekomandimi të ri, qoftë në një mënyrë tjetër të përshtatshme dhe efektive.

### 6.3. Aksesi në marrëveshjet e koncensioneve nuk pengohet nga konfidencialiteti

Qendra Res Publica iu drejtua me një kërkesë për informacion Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (në atë kohë), me anë të së cilës ka kërkuar informacion në lidhje: *“Kopje të marrëveshjes/ marrëveshjeve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Bankers Petroleum”.*

Ministria ka refuzuar dhënien e informacionit me argumentimin se marrëveshja hidrokarbure e kërkuar ka terma konfidencialiteti dhe nuk mund të bëhet publike pa miratimin e palës tjetër.

Res Publica iu drejtua me ankim Komisionerit, i cili me vendimin nr. 79, datë 22.05.2017, vendosi pranimin e ankimit duke u shprehur se:

*“Informacioni i kërkuar nga Res Publica është informacion publik dhe duhet të jepet pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik. Gjithashtu Komisioneri arsyeton se hidrokarburet janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe si të tilla janë pasuri publike, dhe mosbërja publike e marrëveshjeve hidrokarbure me pretendimin e ruajtjes së konfidencialitetit, nuk gjen bazë ligjore dhe shkon kundër frymës së ligjit. Përsa i përket termave konfidenciale, Komisioneri mban qëndrimin që nuk mund të refuzohet i gjithë informacioni në rast se një pjesë e tij përmban të dhëna konfidenciale.”*

Pas vendimit të Komisionerit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për kundërshtimin e vendimit të Komisionerit. Çështja është ende në proces në këtë shkallë gjykimi. Res Publica mbetet optimiste që edhe gjykata do të mbajë të njëjtin qëndrim si Komisioneri.

### 6.4. Publikimi i informacioneve me natyrë statistikore, pavarësisht se statistikat u referohen çështjeve që në dukje kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Kjo lloj çështjeje është rast i përsëritur. Në vitet e kaluara kemi raportuar rastin e publikimit të informacionit lidhur me personat e përgjuar për hir të hetimeve. Pas një debati që përfshiu

<sup>6</sup> Shih Vendimin nr 2 datë 29.01.2018 t dhe vendimi nr. 48, datë 04.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit

Komisionerin për të Drejtën e Informimit, ky i fundit pranoi pretendimin e Qendrës Res Publica që informacionet statistikore nuk kufizohen, bazuar në *parimet e Tshwane*.

Në këtë vit është paraqitur një rast i ngjashëm. Res Publica iu drejtua me një kërkesë për informacion Bankës së Shqipërisë me objekt: *“Vendosjen në dispozicion të listës së kompanive dhe investimeve të tyre, të cilat janë marrë si bazë për raportin “Investimet e huaja direkte: përshkrim metodologjik dhe informacion statistikor për vitin 2015,” botuar nga Banka e Shqipërisë, Departamenti i Statistikave Financiare, Shtator 2016.*

Banka e Shqipërisë refuzoi dhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar me argumentin se këto të dhëna janë konfidenciale dhe janë të aksesueshme vetëm nga një përdorues që ka të drejta në këto të dhëna, si rrjedhojë bazuar dhe në praktikat ndërkombëtare ky informacion nuk mund ti jepet kërkuarit, bazuar në ligjin “Për statistikën” dhe Kodit të Praktikave për Statistikat e Bankës së Shqipërisë.

Pas inspektimeve të kryera nga Komisioneri, ky i fundit zhvilloi një seancë dëgjimore për të debatuar mbi vlefshmërinë e argumenteve për mos dhënien e informacionit nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit, duke marrë parasysh dhe argumentat e Res Publica, e cila solli praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që statistikën dhe lista e kompanive nuk mund të përbëjnë informacion konfidencial, me vendimin nr.10, datë 26.02.2018 vendosi: Pranimin e ankimit të Qendrës Res Publica me argumentimin se:

*“Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të një interesi publik, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë të dhëna statistikore. Gjithashtu Bankës nuk i kërkohet të bëhet publik informacioni i dhënë nga INSTAT, por kërkohet i njëjti informacion statistikor i bërë publik nga vetë Banka e Shqipërisë, por në një mënyrë të ndryshme.”*

Me anë të këtij vendimi Komisioneri edhe një herë theksoi se informacioni që përmban të dhëna statistikore nuk mund të kufizohet, duke krijuar tashmë një praktikë më të konsoliduar<sup>7</sup> në lidhje me bërjen publike të të dhënave statistikore, ndonëse në dukje përmbajnë të dhëna konfidenciale.

Pavarësisht pranimit të ankesës, vendimi i Komisionerit nuk është ekzekutuar nga ana e Bankës së Shqipërisë edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë dhe Res Publica do t’i drejtohet gjykatës.

## **6.5. Publikimi i informacionit për detyrimet tatimore të tatimpaguesve, për të cilat kanë nisur procedurat e mbledhjes me forcë**

Edhe kjo lloj çështje është testuar më herët nga Res Publica, në rastin e mbrojtjes së gazetarit Artan Rama kundër Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Në atë rast, Gjykata Administrative pranoi padinë.

Këtë vit është paraqitur një rast i ngjashëm, ku Res Publica iu drejtua me një kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me objekt: *“A ka detyrime të papaguara nga ana e kompanisë Ionian Refining and Trading Company – IRTC? Çfarë masash/ vendime janë marrë nga*

<sup>7</sup> Shih vendimin nr. 09, datë 23.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit;

*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për detyrimet e papaguara nga kompania Ionian Refining and Trading Company – IRTC, si dhe një kopje të masave/ vendimeve të marra për këtë subjekt.”*

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve refuzoi të vërë në dispozicion të gjithë informacionin me argumentin se shumica e detyrimeve dhe të dhënat e tjera tatimore janë të dhëna konfidenciale dhe e drejta e informimit kufizohet nga detyrimi ligjor i organit administrativ për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave tregtare dhe tatimore të tatimpaguesit. Siç e thamë nuk është rasti i parë që ky organ refuzon të japë informacione me këtë argumentim edhe pse ka të paktën dy vendime gjyqësore në dijeninë tonë (ndjekur nga Res Publica<sup>8</sup>), që e detyrojnë këtë organ të japë informacion të kësaj natyre.

Pas ankimit të Qendrës Res Publica, Komisioneri për të Drejtën e Informimit me Vendimin nr. 44, datë 27.07.2018, pranoi ankimin me arsyetimin se:

*“Argumenti i DPT është i pa bazuar, pasi vetë ligji për “Procedurat tatimore në R.Sh” ka parashikuar rastin e kufizimit për të cilët sanksionon se: nënpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore dhe vendore ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo dispozitë nuk zbatohet për detyrimet tatimore për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë. Gjithashtu rastet e kufizimit të dhënies së informacionit janë parashikuar qartë në nenin 17 të ligjit për të Drejtën e Informimit, dhe informacioni i kërkuar përbën informacion publik që sipas ligjit konsiderohet informacion publik çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.”*

Në këtë rast, Komisioneri ka marrë dhe një masë administrative, vendosjen e gjobës.

## **6.6. Të dhënat financiare të shoqërive tregtare shtetërore**

Qendra Res Publica iu drejtua me një kërkesë për informacion shoqërisë tregtare Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a., me anë të së cilës ka kërkuar informacion në lidhje me pagesat e bëra nga UKT për dëmshpërblime dhe shpenzime gjyqësore, për shkak të humbjes së çështjeve gjyqësore nga UKT për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

UKT sh.a. refuzoi të vërë në dispozicion informacionin e kërkuar. Gjatë hetimit administrativ, UKT është shprehur se pasqyrat financiare të Shoqërisë mund të gjenden të publikuara pranë QKB, ndërsa përsa i përket dëmshpërblimeve të vendosura me vendime gjyqësore, iu referua udhëzimit për përdorimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor, duke arsyetuar në këtë mënyrë refuzimin e dhënies së informacionit.

Qendra Res publica iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit me një ankim, i cili u pranua me Vendimin nr. 51, datë 10.10.2018. Në vendim Komisioneri u shpreh se informacioni i kërkuar është publik, ai përpilohet nga autoriteti publik dhe pavarësisht faktit se pas miratimit të pasqyrave financiare, ato janë depozituar në QKB, nuk mund të refuzohet dhënia e informacionit, duke qënë se është vetë përpiluesi dhe e disponon në versionin origjinal.

8 Shih Studimin “Efektiviteti i ligjit për të drejtën e informimit”, Qendra Res Publica, Tiranë, Dhjetor 2017, fq.32



Me anë të këtij vendimi janë analizuar dy elemente të rëndësishme të ligjit:

Së pari, çfarë kuptojmë me informacion që përpilohet nga institucioni, duke vendosur theksin që në momentin që një institucion ka përpiluar një akt, ai nuk mund të shmanget nga përgjegjësia me argumentin që këtë akt e ka depozituar në një institucion tjetër, por është i detyruar ta vërë në dispozicion të kërkuarit.

Së dyti, në lidhje me detyrimin e autoriteve publike për transparencë dhe llogaridhënie ndaj publikut, ku është me rëndësi të kuptohet se autoritet publike nuk mund të fshihen nga përgjegjësia për të bërë publike veprimtarinë e tyre dhe në mënyrë të veçantë përdorimin e buxhetit, me argumentin që përbën të dhëna konfidenciale.

UKT sh.a. ankimoi vendimin e Komisionerit në Gjykatë, ku Res Publica ishte palë e tretë. Gjykata la në fuqi vendimin e Komisionerit pasi e vlerësoi atë të drejtë. Vendimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm pasi për këtë duhet të kalojnë afatet e ankimit që potencialisht mund të bëjë pala gjyqumbëse.



## VII TE DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Platforma Publeaks.al nisi funksionimin në dhjetor të vitit 2016, për të letësuar përdorimin e ligjit për të drejtën e informimit për çdo qytetar që ka kuriozitetin dhe angazhimin publik për të marrë informacion rreth veprimtarisë shtetërore. Publeaks.al përmban disa rubrika, si ajo e aplikimit të pyetjeve, ajo e gjurmimit të ecures së kërkesës, ajo e programeve të transparencës, etj. Një rubrikë e veçantë është edhe ajo që përmban guida dhe studime në këtë fushë.

Gjatë këtyre dy viteve Publeaks.al është pasuruar me shumë informacione të publikuara, duke numëruar mbi 1370 informacione dhe dokumente zyrtare të publikuara në format lehtësisht të aksesueshëm nga publiku.

Pavarësisht se ky nuk është objekti kryesor i studimit, Res Publica e sheh me interes vështrimin mbi të dhënat rreth aplikantëve. Këto të dhëna mblidhen në momentin e aplikimit online. Jo të gjithë aplikantët kanë dëshiruar të ndajnë me stafin tonë të dhënat e tyre dhe në këto raste është respektuar e drejta për të mbetur anonim. Gjithsesi, edhe të dhënat e personave që kanë dëshiruar të ndajnë të dhënat e tyre, mbahen nga Res Publica dhe përdoren vetëm për qëllime studimore, si ai që paraqitet në vijim, pa evidentuar emra të veçantë aplikantësh.

Res Publica ka përpunuar të dhëna nga aplikimet për indikatorët e mëposhtëm:


- përdorimi i Publeaks.al
- objekti i informacionit të kërkuar
- autoritetet publike të cilëve u drejtohet kërkesa
- arsimit i aplikuesve
- mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve/eve

Indikatorët e mësipërm ndihmojnë për të kuptuar se cili është lloji më i zakonshëm i informacionit të kërkuar, cili grup është më i interesuar dhe kërkon të njihet me veprimtarinë e institucioneve, si paraqitet niveli i njohjes së ligjit në grupe të caktuar, etj.

## 7.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al

Në vijim jepen disa të dhëna lidhur me përdorimin e faqes Publeaks.al:

*Fig. 15 - Numri i klikimeve në faqen Publeaks.al gjatë vitit 2018*




Nga grafiku i mësipërm vihet re se interes më të madh për të vizituar platformën ka pasur në muajin Shtator 2018, ndërsa ka pasur më pak interes në Korrik, kjo presupozohet vjen për shkak se kjo periudhë i përket kohës së pushimeve verore.

## 7.2. Aplikantët sipas kategorive

Nga krahasimi i të dhënave në lidhje me kërkuesit e informacionit, situata paraqitet si më poshtë:

*Fig. 16 - Kategoritë e aplikantëve në Publeaks.al*




Nga grafiku i mësipërm vihet re që këtë vit studimor është rritur ndjeshëm interesimi i qytetarëve të zakonshëm, që tregon rritje të ndërgjegjësimit të tyre dhe interes për informacionin publik. Ky numër gjithsesi ka qenë relativisht i lartë edhe gjatë vitit 2017, gjë që përforcon mendimin se individët marrin rol aktiv nëse dikush ua thjeshton veprimet administrative. Në këtë kontekst, platforma Publeaks.al ka ardhur në ndihmë të qytetarëve, të cilët, pavarësisht kureshtjes së tyre, nuk dëshirojnë të mundohen për të ndjekur vetë procedurat e kërkesave, ankesave, etj.

Për rrjedhojë të rritjes së numrit të qytetarëve të zakonshëm, rezulton të jetë ulur në raport me këta, përqindja e përfaqësuesve të medias dhe aktivistëve të shoqërisë civile.

### 7.3. Aplikantët sipas grupmoshave

Nga të dhënat e mbledhura nga publeaks.al, konstatojmë që subjektet që i janë drejtuar publeaks.al i përkasin të gjitha grup moshave.


*Fig. 17 - Të dhëna për moshën e aplikantëve*



Grup mosha më e interesuar për të marrë informacione gjatë vitit 2018, rezulton të jetë ajo mes 30-40 vjeç, gjë e cila është e pritshme për shkak se kjo moshë është më aktive në shoqëri. Grupmosha më pak e interesuar rezulton ajo 20-30 vjeç. Bie në sy fakti që ka një rritje të ndjeshme të interesit të personave mbi 50 vjeç, ndërsa të rinjtë kanë humbur ndjeshëm interesin në vitin 2018.

### 7.4. Aplikantët sipas arsimimit


Në lidhje me arsimimin e aplikantëve, duke u bazuar në të dhënat e deklaruara prej tyre në rubrikat e aplikimit, konstatojmë që kemi aplikantë me nivele të ndryshme arsimit.

**Fig. 18 - Të dhëna për arsimin e aplikantëve**

Nga të dhënat e grafikut të mësipërm, konstatohet se grupi më i interesuar për të marrë informacione vazhdon të jetë ai me arsim të lartë. Kjo pjesë e popullsisë duket se ka ndërgjegjësim më të lartë për të drejtat dhe ka interes më të madh për çështje publike. Nuk ka ndonjë diferencë të madhe në numrin e aplikantëve me arsim të mesëm ose nëntëvjeçar. Bie në sy fakti që këta persona, ndonëse përbëjnë 85% të popullsisë, angazhohen në këtë fushë vetëm në masën 18%. Kjo demonstroi nevojën për të bërë fushata ndërgjegjësuese për këtë targetgrup me qëllim motivimin e tyre.

### 7.5. Aplikantët/et sipas gjinisë

Raporti i aplikantëve meshkuj dhe femra për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

**Fig. 19 - Të dhëna për gjininë e aplikantëve/eve**

Përsa i përket gjinisë së aplikuesve, edhe për vitin 2018 vihet re se nuk ka ndonjë diferencë gjinore domethënëse përsa i përket interesit për të përdorur të drejtën e informimit.

## **7.6. Publeaks.al si një aplikacion i ri për smartphone**

Një risi, lidhur me platformën publeaks.al është edhe krijimi tashmë i një aplikacioni me emrin Publeaks, i cili lehtëson aksesin në këtë shërbim prej telefonit celular. Nëpërmjet këtij aplikacioni çdo person mund të aplikojë mes telefonit celular në çdo moment dhe nga çdo ambient, duke drejtuar pyetjen e tij në këtë platformë. Futja e kësaj risie vjen në përputhje me trendin e përdorimit gjithnjë e më shumë të telefonave në jetën e përditshme, duke bërë që edhe Publeaks tashmë të jetë “i lëvizshëm”. Aplikacioni është ende në fazën e tij eksperimentale.





## VIII KONKLUSIONE

Si konkluzion të përmbledhur mund të themi se situata e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit është përkeqësuar. Niveli i zbatimit të ligjit nuk përputhet me qëllimin e ligjvënësit dhe me pritshmëritë e ngritura, me të drejtë, kur ky ligj hyri në fuqi në vitin 2014.

Përdorimi i këtij ligji bëhet për arsye të ndryshme, nga kërkues të ndryshëm. Për shembull gazetarët e shfrytëzojnë ligjin për të marrë informacione me qëllim hartimin e raportimeve, investigimeve dhe analizave të tyre. Për këtë arsye gazetarët kanë nevojë të aksesojnë shpejt dhe plotësisht dokumentet e kërkuara, përndryshe ata nuk do të mund të sjellin lajmet në kohën e duhur para një publiku të interesuar mbi zhvillimet e fundit. Aktivistët e shoqërisë civile e përdorin ligjin për të mbështetur aktivitetet e tyre të cilat shpesh kërkojnë planifikim dhe organizim të mirë. Edhe këta kërkues kanë nevojë të kenë siguri juridike për të marrë informacionet në kohën dhe mënyrën e duhur. Qytetarë të tjerë kanë interes të sigurojnë dokumenta për t'i përdorur në çështje gjyqësore, administrative, etj, të cilat janë dinamike dhe nuk lënë shumë kohë për të pritur marrjen e informacioneve. Për shembull, nëse një person është palë e paditur në një gjyq, ai ka vetëm 30 ditë kohë që të përgatisë mbrojtjen e tij dhe nëse dokumentat e kërkuara nuk aksesohen plotësisht brenda këtij afati, atëherë afektohet e gjithë procedura gjyqësore në dëm të tij. Sigurisht që në morinë e përdoruesve të ligjit për të drejtën e informimit, gjenden edhe persona që kërkojnë informacione për të shuar kureshtjen e tyre, dhe mbase kjo kategori është më e duruar në pritjen e përmbushjes së kërkesave, por gjithsesi edhe kjo kategori ka nevojë të aksesojë informacionet brenda kohës kur interesi i tyre për një çështje është ende i lartë.

Në këtë kuptim, fokusi ynë është vënë te pjesa operative që siguron ligji, pra sa është i aftë ky ligj dhe struktura që kujdeset për zbatimit e tij, që të sigurojë aksesimin e informacionit nga publiku, plotësisht dhe në kohën e duhur. Pjesa tjetër, që ka të bëjë me cilësinë e debateve juridike të shtruara para Komisionerit për të Drejtën e Informimit, apo para gjykatave, ndonëse ka rëndësinë e vet për të ardhmen, ka një rëndësi dytësore në raport me operativitetin.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se ligji solli disa risi, të cilat u menduan se do të sillnin ndryshime cilësore dhe do ta ngrinin të drejtën e informimit në një stad shumë të avancuar

në krahasim me ligjin e vjetër të miratuar në vitin 1999. Kështu, publikimi i informacioneve pa kërkesë do të sillte aksesin e menjëhershëm të 80% të informacioneve që zakonisht kërkoheshin. Krijimi i një organi administrativ që do të trajtonte ankesat, do të sillte krijimin e një mjeti efektiv ankimi që do të shpejtonte procedurat administrative, por jo vetëm. Zyra e Komisionerit do të krijonte praktika të mira, të unifikuara, duke rritur cilësinë e vendimmarrjes së çdo autoriteti administrativ në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit. Ulja e afatit të përgjigjeve nga 40 ditë kalendarike në 10 ditë pune, do të sillte informim më të shpejtë. Vendosja e sanksioneve do të sillte mbajtjen nën tryshinë e duhur të administratës për ta trajtuar me seriozitet këtë të drejtë kushtetuese. Gjithashtu publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve do të sillte pasurimin e faqeve të internetit me informacione të kërkuara rishtaz, duke shmangur nevojën e paraqitjes së kërkesave të reja për të njëjtin informacion. E kështu me radhë.

Në vitin 2014, shoqëria civile dhe gazetarët e duartrokitën me entuziazëm miratimin e ligjit të ri, duke shënuar ndarjen nga një periudhë mediokre për të drejtën e informimit, dhe nisjen e një periudhe të re me standarde të tjera. Por, a janë të përmbushura sado pak këto pritshmëri? Sot, pas 4 vitesh, a jemi në një situatë të krahasueshme me atë që mendohej para 4 vitesh? A kemi një progres të vazhdueshëm, apo jemi përpara një frenimi? Nëse po, në cilën pikë ka ndalur ky zhvillim, në një nivel të kënaqshëm gjithsesi, apo në një nivel mediokër dhe alarmant? A mund të themi se ligji nr. 119/2014 pati efekt, apo situata është e ngjashme me atë të mëparshmen?

Duke pasur këto shqetësime dhe pikëpyetje, gjetjet e këtij studimi japin një tablo problematike, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

**a. Për sa i përket programeve të transparencës (publikimi i informacioneve pa kërkesë):**

- Asnjë institucion nga 100 të monitoruar, nuk e ka përmbushur plotësisht programin e transparencës.
- Vetëm 1/7 e autoriteteve kanë përmbushur gjysmën ose më shumë të kërkesave të ligjit për këto programe.
- 60% e autoriteteve të monitoruara kanë informacione të reduktuara dhe të parëndësishme në programin e transparencës.
- 26% e autoriteteve nuk kanë fare një program transparence.
- 10% e autoriteteve të monitoruara nuk kanë as faqe interneti.

Në kushtet kur 100 autoritetet e përzgjedhura për monitorim janë më të rëndësishmit në vend (institucionet kushtetuese, ministritë, drejtoritë më të rëndësishme, bashkitë më të mëdha dhe gjykatat e prokuroritë e rretheve më të mëdha), është e papranueshme që asnjë prej tyre nuk ka përmbushur tërësisht kërkesat e ligjit. Njëlloj është e papranueshme që pjesa dërmuese e tyre kanë përmbushur pak ose aspak kërkesat e ligjit. Në shumë raste vihen re programe me informacione të vjetruara dhe pa vlerë. Situata rezulton të jetë frenuar prej kohësh, në një nivel shumë të ulët, duke përmbushur në mesatare vetëm 24% të kërkesave të ligjit dhe nuk vihen re shenja shprese se e ardhmja do të jetë ndryshe pa një plan masash serioz dhe energjik. Në këtë kuptim, risia ligjore e “programeve të transparencës” mund të konsiderohet si e dështuar. Qytetarët nuk mund të sigurojnë informacione të vlefshme me lehtësinë e një kliku, por do u duhet të bëjnë kërkesa për informacion, njëlloj si në kohën para miratimit të ligjit të ri.

### **b. Për sa i përket infrastrukturës për zbatimin e ligjit**

- Ende 1/4 e autoriteteve më të rëndësishme nuk ka caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, ose nuk ka bërë publike të dhënat e tij.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është plotësuar nga vetëm 1% e autoriteteve. Edhe ky rast i vetëm, nuk ka përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit.
- 38% nuk kanë fare regjistër, ose e kanë atë tërësisht pa informacione.

Nëse vetëm një autoritet publik ka përmbushur deri më sot kërkesat e ligjit (ky autoritet është Komisioneri për të Drejtën e Informimit), mund të thuhet se edhe kjo risi e ligjit ka dështuar. Fakti që një pjesë e rëndësishme e autoriteteve nuk marrin mundimin as të publikojnë një regjistër sa për sy e faqe, tregon për mungesën e theksuar të seriozitetit në trajtimin e këtij aspekti të rëndësishëm. Në këto kushte, asnjë qytetar nuk e përdor dot regjistrin për të marrë një informacion që është kërkuar nga dikush tjetër më herët, por do t'i duhet të bëjë një kërkesë të re, njëlloj siç ndodhte para miratimit të ligjit të ri.

### **c. Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion**

- Vetëm 46% e kërkesave marrin një përgjigje të plotë pas kërkesës fillestare. 25% marrin përgjigje të pjesshme (përgjigje “pa përgjigje”), ndërsa 29% nuk marrin asnjë përgjigje.
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare është rritur ndjeshëm në vitin 2018, në gjithsej 26 ditë kalendarike, duke kaluar edhe kohëzgjatjen mesatare në vitin 2013 kur në fuqi ishte ligji i vjetër, ka qenë 24 ditë kalendarike (sipas një monitorimi të Res Publica në atë kohë).
- Ndonëse në 94% të rasteve merret një përgjigje pas ankimit, kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes është rritur dy herë në vitin 2018, duke arritur në 25 ditë kalendarike.
- Kohëzgjatja e vendimmarrjes së Komisionerit ka shënuar një mesatare prej 54 ditësh.
- Në një pjesë të vogël të kërkesave, por të rëndësishme sepse kanë trajtuar informacione që zakonisht refuzohen pa të drejtë nga administrata, si kontratat e prokurimit, koncensioneve, etj., autoritetet nuk japin përgjigje as pas vendimit të Komisionerit dhe as pas vendimit të gjykatës.

Reagimi ndaj kërkesave është përkeqësuar në raport me të gjitha vitet e mëparshme. Viti 2018 paraqet një rënie të theksuar së të gjithë parametrave kryesorë. Më pak se gjysma e kërkesave marrin përgjigje të plotë. Këto përgjigje nuk jepen në kohën e duhur. Në më shumë se gjysmën e rasteve, përveç humbjes së madhe kohore është vijuar me ankime administrative dhe në disa raste edhe gjyqësore. Informacionet më sensitive nuk aksesohen, deri në pikën që e humbin vlerën. Megjithëse ligji i ri i shkurtoi afatet ndjeshëm, situata është njëlloj me atë përpara këtij ligji. Pra, sjellja e autoriteteve publike është e njëjtë dhe e pandikuar nga ligji i ri. Shihet me shqetësim përdorimi gjithnjë e në rritje i trukut të dhënies së një përgjigjeje të pjesshme dhe evazive. Komisioneri për të Drejtën e Informimit merr shumë kohë për të trajtuar rastet, duke tejkalluar ndjeshëm afatet ligjore, dhe vendimi i tij nuk ka mjaftuar për të siguruar informacione të rëndësishme. Autoritetet që nuk duan të publikojnë informacionet kanë shumë mjete në dorë për të zvarritur dhënien e informacionit pa fund. Informacionet e tjerë, ato që aksesohen më lehtë por përsëri jashtë standardeve ligjore, janë zakonisht informacione që nuk hedhin dritë të rëndësishme mbi veprimtarinë shtetërore.

#### **d. Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit**

- Numri i ankesave të paraqitura para Komisionerit në vitin 2018 është më i larti në të gjithë periudhat. Ndërkohë Komisioneri ka marrë vendim vetëm për afro 5% të rasteve gjatë vitit 2018, duke shënuar shifrën më të ulët të të gjithë viteve.
- Komisioneri ka respektuar afatet ligjore vetëm në 8% të vendimeve të tij. Pjesa tjetër është trajtuar në tejkalim të afateve, deri edhe me 5-6 herë.
- Cilësia e vendimeve të Komisionerit është e mirë dhe si rezultat i hetimeve të plota. Ato përmbajnë një analizë të mirë të balancës midis të drejtave që konfliktojnë me atë të informimit, duke çmuar këtë të fundit vazhdimisht. Debati juridik te Komisioneri është paraqitur serioz dhe palëve u është dhënë mundësia të shprehen dhe të dëgjoen.
- Sanksionet e aplikuara janë shumë të pakta dhe të rralla, me vetëm 4 të tilla gjatë gjithë vitit 2018, në mospërputhje me gjendjen problematike që paraqitet në këtë vit.

Në përgjithësi Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka shfaqur një qasje pozitive ndaj substancës së vendimeve dhe jurisprudencës që krijon. Përveç këtij aspekti pozitiv, të gjithë treguesit e tjerë kanë efektet jo pozitive, duke sjellë si pasojë një lëshim të frerëve të ligjit me rrjedhojë rënien e të gjithë parametrevë të rëndësishëm gjatë vitit 2018.

Në një mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se Komisioneri është kujdesur për të udhëhequr jurisprudencën, por ka lënë mënjanë praktikitetin e ligjit. Në shumë raste Komisioneri ka vepruar duke komunikuar me shkrim me institucionet dhe lënien e një “afati të dytë” në raste të caktuar, duke dërguar grupe inspektimit, duke komunikuar me ankuesit për t’u tërhequr në rastet kur përgjigja është siguruar gjatë këtij procesi “negocimi”, duke organizuar seanca dëgjimore, etj. Këto veprime kanë marrë kohë dhe ndonëse të vlerësueshme për përpjekjet, kanë sjellë efekte anësore në zbutjen e qëndrimeve dhe në relaksim të panevojshëm të zyrtarëve që priren të refuzojnë dhënien e informacioneve.

Jemi të mendimit që qasja e butë e Komisionerit është pasuar me ndryshimin e sjelljes së institucioneve që kanë ulur sasinë e përgjigjeve të plota, duke dhënë përgjigje formale dhe duke dyfishuar kohëzgjatjen e përgjigjes. Vetë Komisioneri ka operuar me kohëzgjatje jashtë afateve ligjore dhe ka marrë shumë pak vendime, ndërkohë që numri i gjobave është i papërfillshëm dhe i aplikuar në raste pa ndonjë domethënie të veçantë. Komisioneri nuk ka shfaqur shenja reagimi energjik ndaj faktit që plotësimi i programeve të transparencës është në nivele tepër mediokër dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve shpesh janë publikuar bosh dhe sa për formalitet. Neglizhimi i transparencës proaktive ka sjellë fluks më të madh kërkesash dhe ankesash, me pasojë rëndimin e punës për vetë Komisionerin.

Res Publica e ka ngritur në çdo raport këtë problematikë, por situata e sotme është tregues i domosdoshmërisë për të marrë në konsideratë rekomandime që jepen në studime të kësaj natyre nga shoqëria civile.

#### **e. Për sa i përket problematikave të veçanta**

- Vijon të pengohet publikimi i seancave dhe vendimeve gjyqësore për shkak të një udhëzimi që mbron pa të drejtë të dhënat personale dhe dëmton të drejtën e publikut për t’u informuar për veprimtarinë e gjykatave.

- Vijon të mos publikohen në kohën dhe mënyrën e kërkuar nga legjislacioni mjedisor dokumenta që kanë të bëjnë me investime dhe veprimtari të tjera me impakt në mjedis.
- Vijon moszbatimi pa shkak i vendimeve të Komisionerit, edhe kur këto vendime nuk janë ankimuar në rrugë gjyqësore nga autoritetet. Vijon sjellja e disa autoriteteve që shfrytëzojnë të gjithë mjetet procedurale për të mos dhënë informacione sensitive që hedhin dritë mbi veprime të dyshuara si korruptive.
- Vijon të ketë një paqartësi për tarifatat e aplikueshme për marrjen e informacioneve (në raste të shpëputura), edhe pse shumë autoritete nuk zbatojnë ndonjë tarifë.

Anonimizimi i të dhënave në gjykata po pengon gazetarët dhe qytetarët që të mësojnë rreth veprimtarisë gjyqësore. Proceset gjyqësore duhet të jenë publikë dhe vendimet e gjykatës gjithashtu. Jo vetëm sepse këtë gjë e parashikon Kushtetuta dhe kodet përkatës, por edhe sepse është zakoni më i vjetër dhe logjik për t'u ndjekur. Jo më kot, gjykatat shumë vende demokratike quhen “court”, “corte”, sepse nënkupton “oborrin” si një vend i hapur dhe jo i mbyllur për publikun. Gjykimet duhet të zhvillohen në vende të tilla që e gjithë shoqëria ta ndjekë. Gjykatat marrin vendimet në emër të Republikës dhe jo në emër të shtetit që është thjesht një produkt i saj. Gjykimi nga Republika do të thotë që gjykimi bëhet nga res publica (në latinisht nënkupton gjënë e përbashkët), pra nënkupton që gjykimi na takon të gjithëve dhe është i yni dhe jo i shtetit në kuptimin e ngushtë. Nëse ka raste ku mund të cenohen të dhënat personale, është vetëm një autoritet i njohur nga ligji që mund të vendosë, dhe ky është gjyqtari/ja që është caktuar me short për çështjen. Askush tjetër. Lejimi i kësaj shtate, ku anonimizimi i seancave dhe vendimeve gjyqësore respekton një të drejtë që nuk prevalon mbi atë të informimit, është në kundërshtim me demokracinë dhe vlerat e republikës.

Problemi tjetër, ai i mospublikimit të dokumenteve të rëndësishëm mjedisorë, pasjell pamundësinë e publikut për të kuptuar dhe reaguar në kohën e duhur ndaj veprimtarive që potencialisht mund të dëmtojnë mjedisin përgjithmonë. Çështjet e mjedisit nuk kufizohen nga kufijtë shtetërorë sepse prekin rajone ose edhe të gjithë globin. Ato nuk kufizohen nga kufij kohorë sepse prekin përtej jetëgjatësisë së njeriut, duke përfshirë brezat e ardhëm që nuk kanë lindur ende. Në këtë kuptim, informacionet dhe dokumentacionet për veprimtaritë me impakt në mjedis nuk shihen me rëndësi parësore, që ato të publikohen menjëherë dhe pa asnjë kërkesë. Komisioneri ka pasur reagim, por situata është ende problematike.

Nga ana tjetër, shfaqet si shumë problematik fakti që vendimet e Komisionerit nuk zbatohen, për shkak edhe të mungesës së mekanizmave të qartë në ligj. Përkundër kësaj mungese, ekzistenca e mekanizmave që ofrojnë të kundërtën, pengimin e zbatimit të vendimeve për vite me radhë, krijon një situatë favorizimi për të gjithë zyrtarët që fshehin qëllimisht informacionet. Si mekanizma të pafavorshëm mund të përmendim faktin që vendimi i Komisionerit nuk është forcërisht i ekzekutueshëm, që autoritetet kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit gjyqësor në gjykata më të larta (jo i domosdoshëm për standardet e një procesi të rregullt ligjor, sidomos në rastin në fjalë), që gjykimi në shkallë të dytë bëhet pas dy ose tre vjetësh, që vendimi i formës së prerë të mos ekzekutohet, etj. Madje Res Publica e ka dërguar një çështje deri në Gjykatën Evropiane për Drejtat e Njeriut, pikërisht sepse vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk ekzekutohet nga Kryeministria dhe se përmbaruesit gjyqësorë janë të pafuqishëm ndaj pushtetit të saj.

Të gjitha këto, sjellin një tablo që rëndon ngjyrat negative të situatës dhe që dikton nevojën për ndërhyrje në ligj.

*f. Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit*

- Interesi i qytetarëve të zakonshëm është rritur gjatë vitit 2018
- Vijon të tregohet interes më i lartë nga persona me arsim të lartë. Pjesa e popullsisë pa arsim të lartë, megjithëse përbën 85% të publikut, angazhohet vetëm në 18% të kërkesave për informacion.
- Ka një rritje të interesit nga grupmoshat mbi 50 vjeç dhe rënie të interesit nga grupmoshat nën 30 vjeç.
- Nuk shfaqen dallime midis gjinive.

Edukimi dhe pjekuria janë faktorët që ndikojnë te personat më të interesuar për të përdorur ligjin për të drejtën e informimit. Rritja e interesit nga qytetarët e zakonshëm mund të jetë pasojë e fushatave ndërgjegjësuese dhe e shërbimeve ndihmëse që këta qytetarë kanë marrë nga shoqëria civile.

## IX REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme që nga vitet e kaluara, rekomandojmë sa vijon:

### **Rekomandimi nr. 1**

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit të kryejë një monitorim të thellë të programeve të transparencës, caktimit të koordinatorëve dhe regjistrave të kërkesave e përgjigjeve, dhe më pas të marrë masa energjike për të riparuar situatën**

Në kushtet kur programet e transparencës nuk janë plotësuar në masë të gjerë, ka ende shumë raste të mos caktimit të koordinatorëve dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve nuk janë përmbushur, Komisioneri për të Drejtën e Informimit nevojitet të angazhohet fillimisht në një fushatë monitoruese për të vlerësuar vetë nivelin e përmbushjes së kërkesave të ligjit. Në vijim, nevojitet të merren masa për të detyruar autoritetet, fillimisht përmes kërkesave zyrtare të dedikuara, dhe më pas nën trysinë e sanksioneve, për rastet që refuzojnë pa shkak plotësimin e kushteve brenda një afati të arsyeshëm.

Në mënyrë të veçantë, Komisioneri mund të nxjerrë udhëzime të posaçme, sidomos për mënyrën e plotësimit të regjistrave.

### **Rekomandimi nr. 2**

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit nevojitet të ndryshojë praktikën në trajnimin e çështjeve, duke i dhënë përparësi dinamikës së kthimit të përgjigjeve**

Komisioneri nevojitet të ndryshojë qasje ndaj sjelljeve në shkelje të ligjit. Nevojitet që të mos vihet theksi vetëm te cilësia e vendimeve të marra dhe te krijimi i një jurisprudence të mirë, por të reagohej shpejt ndaj ankesave, duke marrë me shumë vendime. Dhënia e kohës shtesë për institucionet që nuk janë përgjigjur ndaj kërkesave për informacion nevojitet të reduktohet.

### **Rekomandimi nr. 3**

#### **Komisioneri për të Drejtën e Informimit mund të nxjerrë një seri udhëzimesh të posaçme që kanë vlerën e praktikës së konsoliduar**

Megjithëse ligji parashikon sanksione për çdo rast, Res Publica e ka vlerësuar gjithmonë si të drejtë faktin që ato nuk mund të aplikohen në secilën shkelje të konstatuar. Është e qartë që në disa raste konstatohet se shkelja ka ardhur edhe për shkak të panjohurisë për ligjin, ose për shkak të rrethanave të justifikuara. Deri më sot, Komisioneri ka vepruar duke edukuar koordinatorët përmes trajnimeve dhe ky është një element pozitiv. Megjithatë, përveç trajnimeve, shihet si e nevojshme edhe nxjerra e udhëzimeve të posaçme për çështje të caktuara. Këto udhëzime mund të kenë natyrën e “vendimeve unifikuese” që nxjerr Gjykata e Lartë, pikërisht për të konsoliduar praktikën. Nëse më pas vihet re se zyrtarë të veçuar nuk respektojnë këto udhëzime, Komisioneri është më i justifikuar në përdorimin e sanksioneve. Udhëzimet mund të dalin pikërisht nga sinteza e praktikës së deritanishme, kur numërohen afro 200 vendime. Për shembull, publikimi i kontratave koncensionare apo atyre të prokurimit, publikimi i informacioneve statistikore, publikimi i të dhënave të subjekteve tatimore, publikimi i të dhënave të çështjeve gjyqësore, përdorimi i tarifave, etj, janë çështje që mund të rregullohen një herë e mirë me udhëzime të posaçme, të vlefshme për t’u mbajtur në konsideratë në çdo rast nga koordinatorët.

### **Rekomandimi nr. 4**

#### **Të merren më shumë vendime me sanksione në rrethanat e justifikuara, sidomos në rastet e mosvënies në zbatim të programeve të transparencës**

Res Publica ka rekomanduar edhe më herët përdorimin më të madh të sanksioneve. Në një praktikë administrative të mirë sanksionet duhet të shihen si një e keqe e domosdoshme dhe të përdorshëm vetëm në rastet kur mjetet e tjerë kanë dështuar. Në këto kushte, nuk kërkojmë që Komisioneri të kthehet në një polic për të drejtën e informimit, por të paktën të aplikojë gjobat në rastet kur: (1) Nuk është vënë në zbatim programi i transparencës; (2) shkelësi është dukshëm një përsëritës; (3) shkelësi demonstron dukshëm mosrespektim të ligjit edhe në aspekte të tjerë, si p.sh. nuk kthen përgjigje, por edhe programin e transparencës e ka të pa përmbushur, duke demonstruar neglizhencë të zgjeruar ndaj ligjit; (4) shkelja kryhet edhe në kundërshtim një të udhëzimi konkret të Komisionerit. Në këtë mënyrë, nevojitet që përdorimi i sanksioneve të shoqërohet me nxjerrjen e udhëzimeve siç rekomanduam më lart.

### **Rekomandimi nr. 5**

#### **Nevojitet të rishikohet rekomandimi i dhënë për anonimizimin e të dhënave në gjykata dhe Komisioneri duhet ta bëjë të qartë qëndrimin e tij.**

Udhëzimi për anonimizimin e të dhënave në gjykata është mbështetur edhe nga rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në kushtet kur Komisioneri e ka të qartë që kjo është një praktikë e gabuar dhe njëkohësisht është kujdestar i mbrojtjes së të dhënave personale por edhe i të drejtës së informimit, nevojitet që të mbajë një qëndrim të qartë për këtë aspekt. Në këto kushte Komisioneri mund të ndryshojë rekomandimin dhe kjo mund të shërbejë si bazë e mirë për të kërkuar më pas edhe shfuqizimin e udhëzimit përkatës që ka shkaktuar problemin në fjalë.



### **Rekomandimi nr. 6**

**Të përshtatet modeli i programit të transparencë për natyra të ndryshme të autoriteteve publike me fokus të veçantë publikimin e informacioneve për veprimtari me impakt në mjedis**

Aktualisht vihet re modeli i programit të transparencës nuk është i përshtatshëm njëloj për të gjithë autoritetet publike, duke sjellë vështirësi në zbatimin e tyre, por edhe në përdorimin nga qytetarët. Meqenëse problematika e informacioneve për veprimtaritë me impakt në mjedis paraqet një rëndësi të veçantë, rekomandojmë që të vazhdojnë përpjeket e Komisionerit për implementimin e një modeli që përfshin këto informacione në mënyrë eksplicite.

### **Rekomandimi nr. 7**

**Të parashikohet në ligj mundësia për të ekzekutuar forcërisht vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit**

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë ndryshime në ligj, duke përfshirë një parashikim të veçantë që të mundësojë që vendimet e Komisionerit të jenë tituj ekzekutiv dhe mos ekzekutimi i tyre të përbëjë shkelje administrative.

### **Rekomandim nr. 8**

**Për paditë me objekt kërkim informacioni, vendimi i gjykatës duhet të marrë formë të prerë që në shkallë të parë**

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë që në ligjin nr.49/2012, një nga llojet e padive për të cilat vendimi i gjykatës merr formë të prerë që në shkallën e parë të gjykimit të jenë edhe ato me objekt kërkimin e informacionit. Siç e kemi thënë edhe në studimet e mëparshme, përpara dërgimit të çështjes në gjykatë Komisioneri garanton një procedurë quasi gjyqësore dhe mbyllja e mundësisë së ankimit në një gjykatë më të lartë pas asaj të shkallës së parë nuk është shkelje e procesit të rregullt ligjor sipas standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Rekomandimi nr. 9**

**Rekomandohet të rishikohet kohëzgjatja e mandatit dhe mënyra e emërimit të Komisionerit**

Ligji i jep Komisionerit një mandat 5 vjeçar dhe ai emërohet nga Kuvendi. Në kushtet kur Kuvendi dominohet nga e njëjta forcë politike që më pas dominon edhe autoritetet publike që do të mbikqyren nga Komisioneri, është e rëndësishme që ky i fundit të ketë fuqinë e duhur për të përballuar presionin e natyrshëm politik. Kështu, përveç zgjatjes së mandatit, nevojitet të rishikohet edhe skema e emërimit të Komisionerit, duke përfshirë në këtë skemë elementë kufizues të pushtetit politik dhe futjen e elementëve të pavarur, si për shembull propozimi të vijë nga universitetet, organizatat e mediave, apo shoqëria civile dhe shkarkimi të bëhet vetëm me propozim të tyre, përveç rasteve kur ka një shkelje të rëndë të ligjit apo arsye të tjera të përligjura dhe të pashmangshme, si dorëheqja, etj.

Qendra “Res Publica”  
“E drejta e informimit 2018 - Informacioni i vonuar është  
informacion i mohuar”  
Mbështetur nga:  
Civil Rights Defenders  
Tiranë, Jana 2019  
48 faqe  
Format: 21 x 29.7 cm  
Tirazhi 200 kopje





[www.respublica.org.al](http://www.respublica.org.al)  
[www.publeaks.al](http://www.publeaks.al)



Shkarkoni aplikacionin **“Publeaks”**  
në Android Google Play ose Apple App Store  
dhe përdoreni për të marrë informacion  
nga organet shtetërore